



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 39/4 prot.

Himarë, më 20.09.2021

VENDIM

Nr. 1/2, datë 20.09.2021

**“PËR DISA SHTESA NË PLANIN VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL,
PËR VITIN 2021”**

Në zbatim të nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, vendimit me nr. 111, datë 31.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2021”, vendimit me nr. 86, datë 20.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e Bashkisë Himarë për vitin 2021”

VENDOSA :

1. Miratimin e shtimit të disa pozicioneve në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2021 sipas listës së më poshtme të pozicioneve me kategoritë, klasat dhe grupet përkatëse të administrimit, si rjedhojë e ndryshimeve në strukturën e Bashkisë Himarë.

Nr. Rendor	Kategoria	Numri i vendeve vakante	Klasa	Kategoria e pagës
	Nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtues			
1	Sekretar i Përgjithshëm	1 (një)	I	I-b
	Nëpunës civil të kategorisë së mesëm drejtues			
2	Drejtor i drejtorisë së mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës, pyjeve dhe kullotave	1 (një)	II	II – b
3	Drejtor i drejtorisë së shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes	1 (një)	II	II – b

4	Drejtor i drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse	1 (një)	II	II – b
5	Drejtuës i auditimit të brendshëm	1 (një)	II	II – b
6	Drejtor i drejtorisë juridike	1 (një)	II	II – b
	Nëpunës civil të kategorisë së ulët drejtues			
7	Përgjegjës i njësinë së integritimit evropian dhe investimeve të huaja	1 (një)	III	III-a/1
8	Përgjegjës i sektorit të mirëmbajtjes së objekteve institucionale	1 (një)	III	III-a/1
9	Përgjegjës i sektorit të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës	1 (një)	III	III-a/1
10	Përgjegjës i sektorit të menaxhimit të aseteve	1 (një)	III	III-a/1
11	Përgjegjës i sektorit të prokurimeve dhe procedurave administrative	1 (një)	III	III-a/1
	Nëpunës civil të kategorisë ekzekutive			
12	Specialist auditues i brendshëm	1 (një)	IV	IV-A
13	Koordinator i transparencës dhe konsultimit publik	1 (një)	IV	IV-A
14	Specialist i arsimit dhe rinisë	1 (një)	IV	IV-A
15	Specialist për projektet e BE-së	1 (një)	IV	IV-A
16	Specialist i informimit dhe komunikimit për BE-në	1 (një)	IV	IV-A
17	Specialist i shpenzimeve dhe kontabilitetit të pagave	1 (një)	IV	IV-A
18	Specialist i financës	1 (një)	IV	IV-A
19	Specialist i statistikave dhe menaxhimit të borxhit	1 (një)	IV	IV-A
20	Inspektor i vlerësimit dhe kontrollit të biznesit	1 (një)	IV	IV-A

21	Specialist për kontrollin e zbatimit të investimeve publike e private	1 (një)	IV	IV-A
22	Specialist gjeodez	1 (një)	IV	IV-A
23	Specialist zyre për shërbimet dhe mirëmbajtjen	1 (një)	IV	IV-A
24	Specialist i procedurave administrative	1 (një)	IV	IV-A

2. Ngarkohet *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse* për publikimin e këtij plani në portalin elektronik të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në faqjen zyrtare të Bashkisë Himarë dhe në këndet e publikimeve në Bashkinë Himarë dhe në dy njësitë administrative Horë – Vranisht dhe Lukovë.
3. Ngarkohet *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse* të fillojë kryerjen e procedurave të rekrutimit pas publikimit të këtij plani pranimesh.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Jorgo Goro

